

# Statistikat e Kulturës

## Tremujori II - 2018


**Tiranë, më 2 Gusht 2018:** Numri i shfaqjeve kulturore në tremujorin e dytë 2018 është 279, duke pësuar një rritje me 28,6 % krahasuar me tremujorin e dytë 2017. Në tremujorin e dytë 2018, numri i spektatorëve është 49.678, duke pësuar rënie me 8,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve / ekspozitave në institucionet kulturore**

Numri i shfaqjeve/ekspozitave	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Tr.2-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.2 2017-Tr.2 2018)
Teatri Kombëtar Popullor	36	43	8	56	44	36	-16,3
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	12	21	5	61	24	34	61,9
Teatri Kombëtar Eksperimental	102	76	10	132	149	119	56,6
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	8	15	22	20	18	14	-6,7
Galeria Kombëtare e Arteve	2	5	3	7	0	1	-80,0
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	53	57	18	59	57	75	31,6
<b>Shfaqje kulturore gjithsej</b>	<b>213</b>	<b>217</b>	<b>66</b>	<b>335</b>	<b>292</b>	<b>279</b>	<b>28,6</b>

Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e dytë 2018 është 178 spektatorë/vizitorë për shfaqje, dhe ka pësuar rënie me 28,6 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2017.

**Fig.1 Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje/ekspozitë**



**Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve/vizitorëve në institucionet kulturore**

Numri i spektatorëve /vizitorëve/audiencia	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Tr.2-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.2 2017-Tr.2 2018)
Teatri Kombëtar Popullor	12.310	12.575	3.617	19.888	13.963	8.833	-29,8
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	7.779	16.693	4.583	28.000	12.256	10.709	-35,8
Teatri Kombëtar Eksperimental	13.647	10.974	1.559	17.389	28.068	14.702	34,0
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	360	660	550	960	401	652	-1,2
Galeria Kombëtare e Arteve	1.141	5.841	4.633	27,123	1.334	6.508	11,4
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	7.918	7.396	2.757	8.353	6.493	8.274	11,9
<b>Shfaqje kulturore gjithsej</b>	<b>43.155</b>	<b>54.139</b>	<b>17.699</b>	<b>101.713</b>	<b>62.515</b>	<b>49.678</b>	<b>-8,2</b>

Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve kulturore, 119 shfaqje/ekspozita në tremujorin e dytë 2018. Numri i spektatorëve në tremujorin dytë 2018, është 14.702, duke shënuar rritje prej 34,0 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2017. Numri mesatar i spektatorëve në Teatrin Kombëtar Eksperimental, gjatë tremujorit të dytë 2018, është 124 spektatorë/vizitorë për shfaqje me një rënie prej 13,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Numri i shfaqjeve kulturore të realizuara nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, në tremujorin e dytë 2018, është 75 shfaqje/ekspozita, duke shënuar rritje me 31,6 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2017. Në tremujorin e dytë 2018, numri i spektatorëve është 8.274 duke shënuar rritje me 11,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Numri mesatar i spektatorëve në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, në tremujorin e dytë 2018 është 110 spektatorë/vizitorë për shfaqje, duke pësuar rënie me 15,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

**Tab. 3 Vizitorë në Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala**

	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Tr.2-2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.2 2017-Tr.2 2018)
<b>Muze</b>	<b>13.327</b>	<b>56.375</b>	<b>78.479</b>	<b>52.805</b>	<b>24.477</b>	<b>104.382</b>	<b>85,2</b>
<b>Kala e Monumente të tjera</b>	<b>12.962</b>	<b>58.059</b>	<b>102.621</b>	<b>27.506</b>	<b>18.075</b>	<b>97.508</b>	<b>67,9</b>
<b>Parqe Arkeologjike</b>	<b>8.606</b>	<b>71.773</b>	<b>150.859</b>	<b>29.650</b>	<b>13.872</b>	<b>120.257</b>	<b>67,6</b>
<b>Numri i vizitorëve gjithsej</b>	<b>34.895</b>	<b>186.207</b>	<b>331.959</b>	<b>109.961</b>	<b>56.424</b>	<b>322.147</b>	<b>73,0</b>

Numri i vizitorëve në muze, në tremujorin e dytë 2018, është 104.382, duke shënuar rritje me 85,2 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2017. Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 67,9 %, ndërmjet tremujorit të dytë 2018 dhe të njëjtit tremujor në vitin 2017. Në tremujorin e dytë 2018, numri i vizitorëve në parqe arkeologjike është 120.257, me një rritje prej 67,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

**Tab. 4 Frekuentimi dhe botimet në Bibliotekën Kombëtar**

Treguesit	Tr.1-2017	Tr.2-2017	Tr.3-2017	Tr.4-2017	Tr.1-2018	Tr.2-*2018	Ndryshimi tremujor në % (Tr.2 2017-Tr.2 2018)
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	38.342	22.524	24.798	24.941	19.728	13.966	-38,0
Frekuentimi	35.707	26.294	29.552	32.150	18.662	16.455	-37,4
Numri i botimeve	4.874	3.322	2.851	5.464	4.222	1.832	-44,9
Numri i titujve të rinj gjatë vitit	927	661	609	1.046	815	392	-40,7
Numri i ekzemplarëve të rinj gjatë vitit	3.947	2.661	2.242	4.418	3.407	1.440	-45,9

\* Për muajin qershor mungojnë të dhënat për Bibliotekën Kombëtare të cilat do të raportohen në T3.2018.

Numri i shërbimeve të njësive bibliotekare dhe numri i frekuentuesve të Bibliotekës Kombëtare, në tremujorin e parë 2018, ka pësuar rënie me rreth 38,0 % krahasuar me tremujorin e dytë 2017. Në tremujorin e dytë 2018, në Bibliotekën Kombëtare janë afishuar 1.832 botime, 44,9 % më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga këto botime 392 ishin tituj të rinj dhe 1.440 ekzemplarë të rinj.

# Shënime Metodologjike

Në institucionet qendrore të artit përfshihen: Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), Teatri Kombëtar (TK), Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (TKEKS), Galeria Kombëtare e Arteve (GKA), Cirku Kombëtar (CK), Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF), Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave (QKKFTK), Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala.

Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës.